



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 1214/8 Prot.

Tiranë, më 18.06.2026

VENDIM

Nr. 20, Datë 18.06.2026

PËR
MIRATIMIN E FINANCIMIT TË PROJEKTEVE FITUESE TË THIRRJES PËR
PROJEKT-PROPOZIME TË PËRBASHKËTA NË FUSHAT E KËRKIMIT
SHKENCOR DHE TEKNOLOGJIK SHQIPËRI – AUSTRI 2026–2028

Në zbatim të ligjit nr. 80, datë 22.07.2015 “Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë”, ligjit nr. 109/2024 “Për shkencën dhe kërkimin shkencor në Republikën e Shqipërisë”, ligjit Nr. 8480, datë 27.05.1999 "Për funksionimin e organeve kolegjiale të administratës shtetërore dhe enteve publike", VKM nr. 464, datë 31.07.2025 “Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr. 607, datë 31.8.2016, të Këshillit të Ministrave “Për krijimin, përbërjen, organizimin dhe funksionimin e Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit (AKKSHI), në kuadër të Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Austrisë për Bashkëpunimin Shkencor dhe Teknologjik, nënshkruar më datë 02.05.2012, të Protokollit të Përbashkët, nënshkruar më date 05.12.2014, si dhe Udhëzuesit të përbashkët OeAD–AKKSHI, thirrjes për projekt-propozime të përbashkëta në fushat e kërkimit shkencor dhe teknologjik Shqipëri – Austri 2026–2028, me kërkesë të Agjencisë Kombëtare të Kërkimit Shkencor dhe Inovacionit, Bordi i Administrimit të AKKSHI në mbledhjen e datës 18.06.2026,

VENDOSI:

1. Miratimin e financimit të 7 projekteve fituese në kuadër të thirrjes për projekt-propozime të përbashkëta në fushat e kërkimit shkencor dhe teknologjik Shqipëri – Austri 2026–2028, sipas tabelës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet AKKSHI për zbatimin e këtij vendimi.

Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

BORDI I ADMINISTRIMIT | AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

Znj. Armela Baka, Kryetar
Z. Vasil Tole, Anëtar;
Z. Erjon Uka, Anëtar;
Znj. Mirela Cami, Anëtar;

Znj. Juljana Margariti, Anëtar;
Znj. Anisa Subashi, Anëtar;
Z. Fatbardh Sallaku, Anëtar;
Z. Migel Hidi, Anëtar;



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

THIRRJA BILATERALE SHQIPËRI-AUSTRI 2026-2028

Nr.	Titulli i Projektit	Fusha	Vlera e financimit nga AKKSHI
1	Rëndësia e digjitalizimit në menaxhimin e destinacioneve turistike	Sisteme dhe teknologji Informacioni	774,000 Lekë
2	Barkodimi I AND-së dhe identifikimi gjenetik I bazuar në SNP të taksoneve të Abies dhe hibrideve të tyre në Shqipëri dhe Austri (Abies Hybrid)	Biodeversiteti dhe Mjedisi	794,000 Lekë
3	Vlerësimi i përshtatmërisë së fitogjenëve si aditivë ushqimorë natyral në të ushqyerit e derrave dhe ndikimi I tyre në treguesit e prodhimtarisë dhe shëndetin e derrave	Agrikulturë, Ushqim dhe Bioteknologji	790,000 Lekë
4	Përmirësimi I kompetencave të lidershit tek studentët e infermierisë përmes simulimit: një qasje inovative vlerësues	Shëndetësia dhe Shkencat Mjekësore	754,230 Lekë
5	Biodiversiteti ne deltën e Vjosës; Studimi I llojeve të habitateve tokësore, bletëve, karkalecave dhe bimëve vaskulare	Biodeversiteti dhe Mjedisi	800,000 Lekë
6	Efektet e furnizimit me Azot(N) dhe Kalium (K) në ndërveprim mbi performancën e kulturave dhe pjellorinë e tokës nën kushte të ndryshme klimatike dhe tokësore	Agrikulturë, Ushqim dhe Bioteknologji	753,156 Lekë
7	Inteligjenca artificiale për imazherinë e kancerit ovarian te gratë	Sisteme dhe teknologji Informacioni / Shëndetësia dhe Shkencat Mjekësore	774,000 Lekë

BORDI I ADMINISTRIMIT | AGJENCIA KOMBËTARE E KËRKIMIT SHKENCOR DHE INOVACIONIT

2

Znj. Armela Baka, Kryetar _____

Z. Vasil Tole, Anëtar; _____

Z. Erjon Uka, Anëtar; _____

Znj. Mirela Cami, Anëtar; _____

Znj. Juljana Margariti, Anëtar; _____

Znj. Anisa Subashi, Anëtar; _____

Z. Fatbardh Sallaku, Anëtar; _____

Z. Migel Hidi, Anëtar; _____